



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:122057

Datë: 13.09.2024

Numri i dokumentit: 06157458

Ac.nr.6626/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hysni Bardheci, kryetar i kolegjit, Bujar Muzaqi dhe Enes Mehmeti, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit H.E., nga fshati T.J., Komuna e Ferizajit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson K.A., avokat në Ferizaj, kundër të paditurit S.I., nga fshati P.J., Komuna e Ferizajit, me objekt të kontestit lirimi i pronës dhe kompensimi i dëmit, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.1501/20, të datës 01.06.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 11.09.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurit S.I., nga fshati T.J., Komuna e Ferizajit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.1501/20, i datës 01.06.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktgjykimin e atakuar C.nr.1501/20, të datës 01.06.2021, ka vendosur si në vijim: “I. Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit H.E., nga Fshati T.J. Komuna e Ferizajit dhe Detyrohet i padituri S.I., nga fshati P.J., Komuna e Ferizajit, që ta liroj ngastrën kadastrale nr...ZK P.J. në sipërfaqe prej 695 metra kaltëror dhe të njëjtën të ia dorëzoj në posedim dhe shfrytëzim të pa penguar paditësit H.E., nga Fshati T.J., Komuna e Ferizajit, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi; Detyrohet i padituri S.I., nga Fshati P.J., Komuna e Ferizajit që paditësit H.E., nga Fshati T.J., Komuna e Ferizajit në emër të fitimit të humbur të ia paguaj shumën prej 107.30 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi; II. Detyrohet i padituri S.I., nga Fshati P.J. Komuna e Ferizajit që paditësit H.E., nga Fshati T.J., Komuna e Ferizajit në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t’ia paguaj: për tri seanca gjyqësore 405 euro, për hartimin e padis 104 euro, për taksën për padi 20 euro për ekspertizë të vlerësimit 100 euro, për ekspertizë të gjeodezisë 170 euro në afat prej 7 ditësh nga e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi”.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë i padituri për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit jo të plotë dhe ta gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me të cilën i ka propozuar Gjykatës së Apelit që ta aprovoj si të bazuar ankesën e të paditurit aktgjykimin e atakuar ta ndryshojë, ashtu që të refuzojë kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar ose aktgjykimin e atakuar ta prish dhe çështjen të e kthej në rivendosje në shkallë të parë.

Paditësi nuk ka paraqitur përgjigje në ankesën e të paditurit.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi përmes përfaqësuesit të autorizuar, me datë 28.09.2020, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të paditurit S.I., me bazën juridike pengim posedim, ndërsa përmes parashtrësës së datës 01.02.2021 ka ndërruar bazën juridike të kërkesëpadiës nga pengim posedimi në lirim të pronës duke kërkuar edhe kompensimin e dëmit për shkak të fitimit të humbur. Në padi dhe gjatë seancave gjyqësore ka parashtruar së i padituri me datë 16.09.2020, ka hyrë në parcelën e paditësit pabazë juridike duke e livruar dhe mbjellë ngastrën kontestuese, duke ia cenuar paditësit të drejtën e pronësisë dhe shfrytëzimin e parcelës së tij. Pas nxjerrjes se provës me ekspertizë nga lëmia e gjeodezisë dhe ekspertizës mbi vlerësimin e dëmit të hartuar nga eksperti agronom, ka bërë precizimin e kërkesëpadiës duke i propozuar gjykatës që kërkesëpadija e paditësit të aprohet si e bazuar si në dispozitiv të aktgjykitimit të atakuar. I padituri në seancë gjyqësore e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësit me arsyetimin së tokën kontestuese e ka mbjellë me grurë, pa qenë në dijeni se është e paditësit pasi që këtë tokë në bazë të marrëveshjes verbale e kishte marrë me qira nga B.H.

Gjykata duke vepruar sipas padisë dhe kërkesëpadiës së precizuar të paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, si dhe vlerësimit të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar me numër C.nr.1501/20, të datës 01.06.2021, me të cilin e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykitimit të atakuar.

Në arsyetim aktgjykitimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se nga provat e administruar si dhe faktet jo kontestuese ka vërtetuar se i padituri me datë 16.09.2020 në mënyrë të kundërligjshme e ka penguar paditësin në posedimin dhe shfrytëzimi e qetë të ngastrës kadastrale ... Zona Kadastrale P.J., ashtu këtë ngastër e ka livruar dhe mbjellë me grurë. Gjykata në arsyetim potencon se nga konstatimi dhe mendimi i ekspertit gjeodet është vërtetuar se pronar juridik i ngastrës së sipër përmendur kadastrale është paditësi, ndërsa nga konstatimi dhe mendimi i ekspertit agronom B.H. është vërtetuar se fitimi i humbur i paditësit për shkak të

veprimeve të sipër përmendura të paditurit është në lartësi 107.3 euro. Sa i përket bazës juridike, gjykata është mbështetur në nenet 18 par.1 dhe 93 të LPDTS, nenet 136 par. 1 dhe 137 të LMD, nenin 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe nenin 1 protokollit 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore. Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në nenin 452.1 të LPK-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) i LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së. Po ashtu, ky aktgjykim nuk është i përfshirë as në shkelje tjera ligjore të pretenduara nga pala ankuese në ankesë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1, pika n) të LPK-së. Aktgjykimi nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitiv i aktgjykimit është i qartë dhe arsyetimi përmban arsye të mjaftueshme për të gjitha faktet vendimtare, të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosur lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Lidhur me pretendimin së gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore pasi që nuk e ka udhëzuar të paditurin që të ketë avokat duke e parë përgatitjen e tij shkollorë, Gjykata e Apelit, pas analizimit të procesverbaleve të seancave të mbajtura, gjeti së palës së paditur nuk i është mohuar e drejta për të angazhuar avokat dhe për të paraqitur provave gjatë shqyrtimit gjyqësor. Sipas nenit 11 paragrafi 1 të LPK-së, gjykata e udhëzon palën që nuk është e përfaqësuar nga avokati se cilat veprime procedurale mund t'i kryejë sa herë që konstaton së nga padijenja nuk i shfrytëzon të drejtat procedurale që i takojnë, ndërsa në rastin konkret i padituri nuk ka treguar padijeni në mënyrë që gjykata të udhëzon për veprimet procedurale. Andaj, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, kjo rrethanë nuk ka pasur ndikim në përfundimin e kësaj çështje kontestimore dhe në ligjshmërinë e aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se janë të paqëndrueshme pretendimet e ankimore të palës së paditurës për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, sepse vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike. Kjo pasi që gjykata përmes këqyrjes në vend së bashku me ekspertin e gjeodezisë M.L., i cili e ka përpiluar ekspertizën e datës 12.03.2021, ka bërë identifikimin e ngastrës kontestuese ku është konstatuar së e njëjta është mbjellë më grurë nga i padituri. Në bazë të ekspertizës së gjeodezisë dhe certifikatës së pronës për njësinë kadastrale nr. P-..., gjykata ka vërtetuar së ngastra kontestuese evidentohet në pronësi të paditësit, dhe kjo ngastër me parë ka qenë pjesë e një ngastre tjetër në pronësi të T.H., të cilën ky i fundit e ka ndarë në dy parcela dhe në bazë të kontratës së këmbimit nr.LRP.nr.308/2018 dhe Ref.72/2018, të datës 05.01.2018, njërën prej këtyre parcelave,

përkatësisht atë që është objekt shqyrtimi në këtë çështje, ia ka kaluar në pronësi paditësit H.E.. Pra, nga certifikata e pronësisë rezulton së paditësi ka qenë pronar i ngastrës kontestuese që nga viti 2018, ndërsa nuk ishte kontestuese fakti se i padituri me datë 16.09.2020, e ka livruar dhe mbjellë me grurë parcelën kontestuese duke e shfrytëzuar të njëjtën pa pëlqimin e paditësit i cili është pronar, me arsyetimin së tokën në fjalë e ka marrë me qira për vitin 2020 dhe 2021, nga B.H. Ndërsa sa i përket dëmit i cili iu ka shkaktuar palës paditëse për shkak të pamundësisë së shfrytëzimit të ngastrës kontestuese gjykata përmes ekspertizës së ekspertit agronom B.H., të datës 19.04.2021, ka konstatuar se fitimi i humbur i paditësit për shkak të veprimeve të paditurit është në lartësi 107.30 euro, e cila shumë është llogaritur duke marrë për bazë të hyrat që paditësi do t'i realizonte në vitin kalendarik vjeshtë 2020 dhe korrik 2021, nga parcela në fjalë duke u mbjellë me grurë, bazuar në çmimet e tregut të këtij produkti. Andaj, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike.

Nuk qëndrojnë as pretendimet e palës së paditur se gjykata e shkallës së parë ka bërë zbatimin e gabuar të së drejtës materiale. Kjo sepse gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se i padituri me veprimet e tij, paditësit ia ka cenuar autorizimet të cilat i rrjedhin nga e drejta e pronësisë mbi ngastrën kontestuese, e të cilat autorizime i përcaktohen me nenin 18 par.1 të Ligji nr. 03/1-154 për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore - LPDS, sipas të cilit: *“Pronësia është e drejta e tërësishme në një send. Pronari mund të disponojë me sendin sipas dëshirës së tij, veçanërisht atë ta posedojë dhe ta përdorë, me atë të disponojë dhe të tjerët t'i përjashtojë nga çfarëdo ndikimi, nëse nuk kundërshtohet nga ligji ose nga të drejtat e një të treti”*. Për më tepër, gjykata e shkallës së parë me të drejtë i është referuar edhe nenit 93 të LPDS-së me të cilin përcaktohet se: *“Pronari mund të kërkojë kthimin e sendit të caktuar prej secilit i cili nuk ka të drejtë posedimi”*, nga i cili nen paditësit i rrjedh e drejta për të kërkuar kthimin e sendit nga i padituri, si dhe nga i cili formohet baza ligjore për aprovimin e kërkesëpadisë së paditësit dhe për detyrimin e të paditurit që t'ia dorëzojë paditësit në posedim dhe shfrytëzim të lirë ngastrën kontestuese. Gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale kur ia ka njohur paditësit të drejtën e kompensimit të dëmit material për shkak të fitimit të humbur në shumën e përcaktuar si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar, duke u mbështetur në nenin 137 të Ligjit Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve-LMD, sipas të cilit: *“Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)”*. Ndërsa sipas nenit 136 par.1 të LMD-së është paraparë së *“Kush i shkaktonte tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*. Në rastin konkret lartësia e dëmit është konstatuar në bazë të ekspertizës së ekspertit agronom, i cili dëm është shkaktuar nga i padituri për shkak së i njëjti duke lavruar dhe mbjellë ngastrën kontestuese pa autorizimin e paditësit, ia ka pamundësuar të njëjtë shfrytëzimin e ngastrës e cila është pronë e tij. Andaj, Gjykata e Apelit vlerëson që si rrjedhojë e konstatimit të saktë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata e shkallës së parë drejtë ka aplikuar edhe të drejtën materiale, duke e aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar.

Sa i përket pretendimit së i padituri nuk e ka uzurpuar ngastrën kontestuese por këtë e ka punuar sipas udhëzimit të ish pronarit Bashkim Haliti, dhe i njëjti nuk ka pasur informata së kjo ngastër është ndërruar, Gjykata e Apelit, vlerëson së fakti së i padituri nuk ka pasur raport kontraktual

me paditësin dhe e ka shfrytëzuar ngastrën kontestuese pa autorizimit e paditësit si pronar paraqet bazë ligjore për aprovimin e kërkesëpadisë së paditësit. Siç është konstatuar me sipër paditësi të drejtën e pronësisë në ngastrën kontestuese e ka bartur që nga viti 2018, nga ish pronari T.H., çka rezulton së B.H. edhe me parë nuk ka qenë pronar i kësaj ngastre, andaj nëse i padituri pretendon së është vënë në lajthim nga Bashkim Haliti, i cili sipas tij ia ka dhënë më qira ngastrën kontestuese, për dëmin eventual që të njëjtit i është shkaktuar nga ky raport detyrimor i pretenduar mund t'i drejtohet personit në fjalë.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është vlerësuar se është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, dhe në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë se shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e nenit e neni 449, 452 dhe 463 të LPK-së.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi të gjitha pretendimet tjera ankimore të palëve ankuese, por që nuk kishin ndikim për të vendosur ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartcekurat, e në mbështetje të dispozitave nga nenet 194 dhe 195.1, pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.6626/2021, datë 11.09.2024

Kryetar i kolegjit, Gjyqtari
Hysni Bardheci